



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 05.11.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, dhe Zafir Berisha.

Munguan: Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Srgjan Mitroviq.

Pjesëmarrësit e tjerë: Marigonë Drevinja, PSD-Kuvend, Artan Murati e Shqipron Xhema, KDI dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 2 dhe 17 tetor 2018;**
- 3. Angazhimi i ekspertit për Strategjinë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar;**
- 4. Angazhimi i ekspertëve për grupet punuese;**
- 5. Zgjerimi i listës ekzistuese të ekspertëve;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Vjosa Osmani- Sadriu propozoi që pika e 5 e rendit të ditës të renditet si pikë e tretë, në mënyrë që të bëhet zgjerimi i listës së ekspertëve para se të miratohet angazhimi i ekspertëve për çështjet vijuese.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës me ndryshimin e propozuar.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 2 dhe 17 tetor 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 2 dhe 17 tetor 2018.

3. Zgjerimi i listës ekzistuese të ekspertëve

Vjosa Osmani -Sadriu, njoftoi anëtarët e komisionit, se ekziston një listë e ekspertëve për fushën e komisionit tonë nga viti 2008, e cila ka pasur shumë pak ndryshime në ndërkohë. Disa prej emrave në këtë listë kanë vazhduar me profesione të tjera, megjithatë ka edhe ekspertë që janë angazhuar nga KDI dhe organizata të tjera për projekte dhe për çështje për të cilat kemi qenë të interesuar si komision. Për zgjerimin e listës ekzistuese, kërkoi nga anëtarët e komisionit që të japin propozimet e tyre. Ajo propozoi që lista të zgjerohet me ekspertët prof. Qerim Qerimi, profesor i të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; prof. Kushtrim Istrefi, ligjërues i marrëdhënieve dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe Donikë Qerimi, ligjëruese e të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Po ashtu njoftoi anëtarët e komisionit për përgatitjen, eksperiencën dhe angazhimin e kandidatëve të propozuar për hartimin e ekspertizave. Znj. Osmani theksoi se është e nevojshme të angazhohet një ekspert për plotësimin e ndryshimin e Strategjisë për marrëdhënie ndërkombëtare, e po ashtu edhe për nevojat e grupeve punuese. Bëri të ditur se Strategjia për marrëdhënie ndërkombëtare duhet të miratohet në fillim të dhjetorit në mënyrë që Kuvendi ta miratojë para vitit të ri, meqë është obligim i paraparë në Planin për zbatimin e MSA-së. Njoftoi se ekziston një dokument, i cili është përgatitur nga Projekti i binjakëzimit, i cili duhet të plotësohet me kërkesat e anëtarëve të komisionit dhe për të cilin është e rëndësishme që të ketë një ekspertizë, e më pas të miratohet apo jo, në komision.

Elmi Reçica, lidhur me propozimin e kandidatëve për zgjerimin e listës ekzistuese të ekspertëve, tha se pajtohet që ekspertët e propozuar nga kryetarja të hedhen në votim për plotësimin e listës ekzistuese dhe që anëtarët e tjerë të komisionit të japin propozimet e tyre nëse kanë për zgjerimin e listës ekzistuese.

Zafir Berisha propozoi z. Granit Jeminin, pjesë të listës të ekspertëve të fushës së komisionit, për të cilin tha se ka studiuar dhe magjistruar në Gjenevë dhe se i njeh disa gjuhë të huaja.

Glauk Konjofca, lidhur me kandidatin e propozuar nga deputeti Zafir Berisha për listë të ekspertëve të fushës së komisionit, tha se z. Granit Jeminin do ta propozojë në cilësi të ekspertit në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, meqë i takon drejtimit të biznesit.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Lista ekzistuese e ekspertëve zgjerohet me kandidatët: z. Qerim Qerimi, znj. Donikë Qerimi dhe z. Kushtrim Istrefi.

4. Angazhimi i ekspertit për Strategjinë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar

Vjosa Osmani -Sadriu, lidhur me nevojën e angazhimit të një eksperti për hartimin e Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar, tha se duke pasur për bazë draft-strategjinë e hartuar nga Projekti i Binjakëzimit, propozoi që të kontaktohet prof. Qerim Qerimi dhe nëse ai nuk do të ketë mundësi angazhimi, të kërkohet angazhimi i Dren Dolit ose i Blerim Rekës nga lista ekzistuese e ekspertëve. Ajo njëkohësisht propozoi që në mbledhjen e radhës të zgjerohet lista e ekspertëve me propozimet e tjera të anëtarëve të komisionit, ndërsa anëtarët që janë në udhëtim zyrtar mund t'i propozojnë ekspertët përmes emailit duke ia bashkëngjitur CV-në e ekspertit, e më pas të shqyrtohen dhe votohen në komision.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Për plotësimin dhe ndryshimin e Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar të kontaktohen për angazhim sipas radhës, varësisht prej angazhimeve të tyre, z. Qerim Qerimi, dhe nëse ai nuk do të ketë mundësi angazhimi të kontaktohen z. Dren Doli dhe z. Blerim Reka.

5. Angazhimi i ekspertëve për grupet punuese

Vjosa Osmani -Sadriu tha se duke pasur parasysh se dy grupe punuese të komisionit janë në proces pune, njëri me mbikëqyrjen e ligjeve nga fusha e politikës së jashtme e tjetri nga fusha e diasporës, pyeti anëtarët e komisionit nëse vlerësojnë angazhimin e ekspertëve për të ndihmuar në punën e tyre.

Time Kadrijaj theksoi se meqenëse janë duke i realizuar dëgjimet publike për projektligjin për diasporën propozoi që pas përfundimit të konsultimeve publike të shikohet mundësia angazhimit të ekspertit, e po ashtu kontaktet të cilat i kanë gjatë këtyre dëgjimeve me ambasadat dhe konsullatat, ato mund të shfrytëzohet për çështjen e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga fusha e politikës së jashtme.

Vjosa Osmani- Sadriu theksoi se janë të informuar nga Ministria e Diasporës se pas dëgjimeve publike, në mesin e dhjetorit do ta procedojnë projektligjin në Kuvend. Komisioni do të mund të angazhonte një ekspert që do të punonte në P/ligj së bashku me deputetët që kanë qenë pjesë e dëgjimeve publike dhe grupin punues. Propozoi që ky P/ligj të mos zvarritet pasi që kemi qenë pjesë e dëgjimeve publike dhe i dimë sfidat dhe vërejtjet e diasporës të cilat mund të propozohen si amendamente. Për ekspertizë për P/ligjin për diasporën tha se nuk është e nevojshme të angazhohen ekspertë më gjatë se një javë, përderisa bëri të ditur se angazhimi i ekspertëve është i mundur nga 5 deri në 22 ditë pune.

Elmi Reçica theksoi se është e rëndësishme që komisioni të gjej një ekspert të mirë për diasporën, që është aktiv, që është dëshmuar dhe i cili mund të mbështes në këtë çështje.

Vjosa Osmani- Sadriu theksoi se pajtohet nëse anëtarët e komisionit kanë propozime për ekspertë të shqyrtohen në ndërkohë dhe vendoset për angazhim.

Glauk Konjufca njoftoi se ka qenë në dëgjimet publike për draftin e ligjit për diasporën, por se ky draft është shumë larg përmbushjes së nevojave që i ka paraqitë diaspora si probleme. Nëse krahasohet Ligji i Diasporës që është në fuqi dhe drafti i ri, tha se dallimi në mes tyre është minimal. Drafti i propozuar nga ministria nuk dallon as 10% apo 20% prej ligjit në fuqi të vitit 2012. Draft-ligji për diasporën tha se i ka 30 nene, që do të thotë se i ka 10 nene më tepër nga ligji në fuqi, dhe se nuk e arrin objektiven e tyre duke pasur parasysh kërkesat e diasporës. Sipas vizitave të planifikuara për dëgjime theksoi e ky projektligj nuk mund të finalizohet deri në muajin prill.

Vjosa Osmani -Sadriu tha se pas këtyre vizitave shpreson se MDIS do ta plotësojë draft - ligjin sipas kërkesave dhe nëse nuk do të merren parasysh kërkesat e diasporës. Komisioni duhet të punojë gjatë për mundësinë e plotësimit të tij. Ajo theksoi se çështjet të cilat kanë të bëjnë me diasporën nuk mund të rregullohen të gjitha vetëm me ligjin për diasporën sepse prekin edhe Ligjin për RTK, Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, si dhe rregulloret e miratuara nga KQZ.

Glauk Konjufca theksoi se qëndrimi i pjesës dërmuese të diasporës ka qenë kundër një televizioni publik të pavarur për diasporën, këtë e konsiderojnë të dëmshme dhe shpëputje nga Kosova.

Time Kadria për të diskutuar lidhur me draft -ligjin tha se do të duhej diskutuar pas përfundimit të dëgjimeve për projektligjin, me të gjitha kërkesat e diasporë, sepse ato dallojnë nga vendi në vend. Diaspora e Zvicrës tha se dallon nga diaspora e Suedisë dhe kanë qëndrime të kundërta.

Elmi Reçica theksoi se komisioni nuk duhet ngutur me shqyrtimin e P/ligjit për diasporën, por edhe diaspora duhet të ftohet në dëgjime publike për t'i shprehur interesat e tyre. Propozoi që pas kryerjes së dëgjimeve lidhur me këtë projektligj, komisioni ta shqyrtojë atë në një mbledhje të veçantë.

Zafir Berisha tha se diaspora jonë është në vende të ndryshme dhe ka kërkesa të ndryshme, por me rëndësi është që të hartohet një ligj i cili i përafrohet kërkesave të përgjithshme, pa dallim se në cilat shtete jetojnë ata.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Me rastin e procedimit të P/ligjit për Diasporën në Kuvend për shqyrtim, të angazhohet një ekspert nga lista e ekspertëve për të ndihmuar punën e komisionit.

6. Të ndryshme

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi deputetët se sa i përket raportimit të ministrit të jashtëm, kërkesa e komisionit është e vazhdueshme. Ajo tha se është kërkuar nga ministri që të raportojë për rezultatin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, për procesin e njohjeve, për deklaratat lidhur me tërheqjen e njohjeve, mirëpo ministri vazhdimisht thotë se është jashtë vendit dhe nuk i është përgjigjur ftesës për raportim. Më tej tha se do të insistojë që ministri të

raportoj në Komision, ngase ka disa muaj që ministri i jashtëm nuk ka raportuar në komision për këto tema.

Kryetarja e Komisionit po ashtu i njoftoi anëtarët e komisionit se nga ministri i jashtëm ka pranuar një shkresë për komisionin, sipas së cilës komisioni nëse ka sugjerime lidhur me Interpol-in t'i dërgojmë. Lidhur me këtë shkresë tha se personalisht do t'i përgjigjet ministrit se tani është vonë të kërkojë sugjerime nga komisioni dhe se pa u njoftuar komisioni lidhur me rrjedhën e procesit është e vështirë të jap sugjerime. Ajo kërkoi nga deputeti Elmi Reçica që të mbajnë një takim të mbyllur ku do të merrnin pjesë nga një përfaqësues i secilës parti politike, për t'u njoftuar me rrjedhat e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Interpol.

Elmi Reçica theksoi se dakordohet që ftesa për ministrin e Jashtëm të jetë permanente dhe se është i gatshëm për mbajtjen e takimit të mbyllur lidhur me procesin e anëtarësimit në Interpol.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Njësia për mbështetjen e komisionit.